

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

| DATA | Tërheqje likuiditeti | | |
|------------|----------------------|-------------|----------------|
| | REPO njëjavore | REPO mujore | REPO tremujore |
| 05.01.2006 | 1,106.00 | | |
| 12.01.2006 | 4,009.00 | | |
| 19.01.2006 | 1,959.00 | | |
| 26.01.2006 | 4,760.00 | | |
| 02.02.2006 | 5,070.00 | | |
| 09.02.2006 | 1,580.00 | 850.00 | 1,000.00 |
| 16.02.2006 | 5,602.00 | | |
| 23.02.2006 | 3,152.00 | | 1,040.00 |
| 02.03.2006 | 4,308.00 | | 1,100.00 |
| 09.03.2006 | 510.00 | 100.00 | 300.00 |
| 16.03.2006 | 4,713.00 | | |
| 23.03.2006 | 4,712.00 | | |
| 30.03.2006 | 5,629.00 | | |

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, sistemi bankar u karakterizua nga teprica e likuiditetit. Rritja e depozitave me ritme më të larta se kredia në lekë, si dhe gjendja e lartë e likuiditetit në llogarinë e qeverisë ishin faktorët kryesorë që sollën rritjen e terpricës së likuiditetit të sistemit bankar. Likuiditeti i qeverisë kaloi në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet uljes së emetimit të bonove të thesarit në tregun primar si dhe nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes midis Ministrisë së Financave dhe sistemit bankar.

Duke marrë në konsideratë parashikimet për vazhdimin e gjendjes së tepricës së likuiditetit, bazuar kjo

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).


edhe në parashikimin e qeverisë për gjendjen suficit të buxhetit gjatë pjesë së parë të vitit, si dhe për të lehtësuar presionin që ushtronte kjo tepricë mbi interesat e tregjeve, Banka e Shqipërisë në ankandin e bonove të thesarit të javës së dytë të muajit mars, uli investimin e saj në bonot e thesarit me maturim 6-mujor me shumën 1.50 miliardë lekë.

Për të administruar likuiditetin dhe nivelin e interesave krahas instrumentit kryesor të tregut (*marrëveshje riblerjeje me maturim javor*) dhe tërheqjes së përhershme të likuiditetit nëpërmjet tregut primar, Banka e Shqipërisë përdori edhe instrumentet rregulluese, *marrëveshjet e riblerjes me maturim mujor dhe tremujor*. Likuiditeti i tërhequr nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me maturim tremujor ishte 3.44 miliardë lekë, ndërsa me marrëveshje mujore riblerjeje u tërhoqën 0.95 miliardë lekë. Në bazë javore, Banka e Shqipërisë tërhoqi mesatarisht 3.6 miliardë lekë nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor.

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetës

Në mbështetje të ndërhyrjeve me instrumentet e tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 736 milionë lekë në krahasim me 1,035 milionë lekë, në tremujorin e kaluar. Në kushtet e tepricës së likuiditetit dhe e plotësimit të nevojave në tregun ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore nuk gjeti përdorim gjatë tremujorit të parë të vitit 2006.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2006.



Grafik 1: Ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në tremujorin e parë të vitit 2006.

2. NDËRRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të parë, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor, duke blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë në funksion të përmbushjes të objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto. Efekti i rezultatit neto nga ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë ka qenë rritje e rezervës valutore me 2.42 milionë euro dhe 3.90 milionë usd me kurs mesatar 122.80 lek/euro dhe 101.82 lek/usd.

2.2 Veprime të tjera

Gjatë kësaj periudhe, kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës përcaktohen nga detyrimi i Qeverisë Shqiptare për shlyerjen e kësteve të borxhit të jashtëm, ku pagesat e kryera gjatë tremujorit të parë, llogariten në 1,396.63 milionë lekë (70.56 për qind e kësaj shume përfaqëson shitje të dollarit amerikan).

Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave llogaritet në 141.00 milionë lekë dhe lidhet me përdorimin e fondeve të derdhura në favor të Qeverisë shqiptare për projekte të saj. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 14.19 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA) dhe 3.50 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).